



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE**

MIRATOHET

**Dritan LELI
K R Y E T A R**

ANALIZA E KOSTOS

**SHERBIMI I PASTRIMIT NE QYTETIN E VLORES DHE NJESISA
ORIKUM**

Hyrje

Bashkia e Vlorës përfshin të gjithë zonën bregdetare nga Lumi i Vjosës në veri deri në Qafën e Llogorasë në jug, duke përfshirë gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit. Në këtë territor shtrihen tre qendra të rëndësishme të turizmit detar, Vlora, Radhima dhe Orikumi, si edhe zonat rurale blegtorale të Tragjasit. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detaro-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vedin tonë.

Tendencat demografike kanë qenë ato të një qyteti që ka pësuar si emigrimin edhe migrimin nga zonat rurale në atë urbane. Emigrimi i popullsisë dallohet edhe nga diferenca e theksuar mes numrit të popullsisë të regjistruar në gjendjen civile dhe numrit të nxjerrë nga censusi.

Zona Gjeografike: Bashkia e Vlorës kufizohet në veri me Bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Vlorës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia ka 104.827 banorë. Gjithsesi, në regjistrin civil në këtë bashki rezultojnë si popullsi banuese 201,834 persona. Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km². Nëse merren parasysh të dhënat e censurit, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 169.9 banorë për km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrit civil, densiteti është 325 banorë për km².

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe qarkut të Vlorës. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani.

Vlora ka si burim kryesor ekonomik turizmin dhe bujqësinë e përqendruar te blegtoria dhe ulla. Si një qytet bregdetar, Vlora është edhe një qendër e rëndësishme e peshkimit.

Qytetet e Vlorës dhe të Orikumit si dhe fshati Radhimë janë përfshirë përgjatë dekadës së fundit nga një bum ndërtimi i cili ka krijuar probleme në mjedis dhe në menaxhimin e mbetjeve të ngurta si dhe ka krijuar mbingarkesë të madhe mbi shërbimet publike bazë si rrugët, ujësjellësi dhe kanalizimet.

Sfidat më të cilat përballen pushteti vendor

Menaxhimi urban dhe infrastruktura bazë janë problemet kryesore me të cilat përballen bashkia, bashkë me menaxhimin e mbetjeve të ngurta apo mbetjeve të zakonshme. Qyteti tashme ka një plan urbanistik gjithëpërfshirës për të gjithë vijën bregdetare, gjithsesi shtrirja gjeografike dhe shpërndarja e shërbimeve e bëjnë dhënien e shërbimeve komunale më të vështirë.

Dy qytetet, Vlora dhe Orikumi, kanë probleme me ndotjen me karakter urban, zonat rurale të ish-komunave Qendër, Novoselë dhe Shushicë, kanë nevojë për të zhvilluar potencialin e tyre të lartë bujqësor e blegtoral, si dhe mirëmenaxhimin e infrastrukturës bujqësore.

Për sa me lart realizimi i shërbimit të pastrimit në qytetin e Vlorës dhe njësinë Orikum synon të ngrejë në nivel me cilësor realizimin e këtij shërbimi. Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane, në vetvete

përmban disa komponentë. Ne studimin e hartuar qëllimi primar është ofrimi i shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e Bashkisë së Vlorës në cilësinë maksimale si ndaj qytetareve dhe biznesit ashtu dhe ndaj turistëve. Këtë përmirësim cilësor në ofrimin e shërbimit e mundësojnë gjithashtu dhe investimet e kryera në infrastrukturën e qytetit këto 4 vite që u mbyllën. Investimet kanë konsistuar në zgjerimin e rrjetit rrugor në parametrat e kërkuar, ku përfshihen Shëtitorja “Lungomare”, rruga “Poliklinika – 7 pallatet”, “7 Pallatet – Dhimiter Konomi”, Rruga Sazani, Rruga Transballkanike, rruga Ramize Gjebrea (Unaza), e rrugë të tjera të rikonstruara. Rikonstruksioni i plote i 6 blloqeve të banimit, të cilët deri më tani nuk kanë pasur cilësinë e duhur për ofrimin e shërbimit të pastrimit. Gjithashtu numri në rritje turistëve të cilët nga viti në vit shtohen në Bashkinë e Vlorës, ku sipas statistikave numri i popullsisë gjatë pikut të sezonit turistik dyfishohet.

Për sa më lart studimi ka marrë në konsideratë kërkesat për ofrimin e shërbimit duke bërë vlerësimin e kostove përkatëse për këtë shërbim bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr.8094 datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave", ku janë të përcaktuara qartë parimet e përgjithshme:

- 1. Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit.*
- 2. Garantimin e kërkesave higjieno-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës.*
- 3. Të ruajë e të mbrojë faunën e florën dhe degradimin e mjedisit e të peizazhit.*

Bashkia e Vlorës si një bashki turistike dhe bregdetare është karakterizuar nga një realizim cilësor i këtij shërbimi në vitet e kaluara. Në asnjë rast nuk kanë ekzistuar problematika të heqjes së mbetjeve urbane, të shpërndarjes së kontejnerëve, të fshirjes së rrugëve etj. Megjithatë edhe ky shërbim ka pasur problematikën e veta, për shkak të rritjes demografike të popullsisë së qytetit, shtrirjes territoriale, ndërgjegjësimi i ulët i banorëve në hedhjen e mbeturinave.

Gjithashtu hartimi i këtij studimi është bazuar dhe në projektin për “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta” në Rajonin e Vlores i cili mbulon pjesën veriore të Rajonit të Vlorës, përkatësisht bashkitë e Vlorës dhe të Selenicës. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është dhënia e kontributit për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta, përmes investimeve në infrastrukturën e mbetjeve të ngurta dhe mbështetjen institucionale për dhënien e një shërbimi të përmirësuar në pjesën veriore të rajonit të Vlorës. Në këtë mënyrë mbështetet strategjia kombëtare e mbetjeve si dhe harmonizimi i standarteve me ato të Bashkimit Europian (BE) si edhe përmirësohen kushtet e jetesës së popullsisë, gjithashtu edhe kushtet mjedisore.

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, i cili do të zbatohet do të jetë i plotë si nga ana mjedisore ashtu edhe nga ajo teknike në bazë të standarteve të BE. Për më tepër ai do të përshtatet me nevojat dhe kapacitetet në zonën ku do të shtrihet projekti për sa i përket menaxhimit institucional, operimit dhe mirëmbajtjes së landfilleve dhe të gjithë ambjenteve/godinave respektive si edhe të përshtatet me mundësitë financiare të banorëve të zonës ku do të shtrihet projekti.

Miratimi i këtij projekti i ka hapur rrugë fillimit të procedurave për përthithjen e një investimi prej 20,8 milion euro, për “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta”. Nga të cilat 12 milion euro në formë kredie, Bashkia e Vlores do të përdorë Huanë për: (i) investimet për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta; (ii) shpërndarjen e pajisjeve për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta; në përputhje me Nenin 1.2 të Marrëveshjes së Huasë.

dhe 8.8 milion euro në formë granti të cilat do të shërbejnë për rehabilitimin e plote të fushave ekzistuese të mbetjeve.

Pjesë e këtij projekti janë dhe shërbimet e këshillimit nga një konsulent institucional i cili është përzgjedhur nga Banka Gjermane për Zhvillim dhe Agjencia Kombëtare e Ujesjelles Kanalizimeve

dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

Ekspertët e konsulentit kanë punuar gjatë gjithë kësaj periudhe me specialistët e Bashkisë Vlorë në hartimin e këtij studimi, pjesë të këtij studimi janë të dhënat që janë përdorur në llogaritjen e kostos.

Në llogaritjen e kostos për periudhën e ofrimit të shërbimit të pastrimit është bazuar në metodologjinë aktuale të kontratave ekzistuese (Ngarkim, transport mbeturinë; fshirja e rrugëve dhe shesheve; larje dhe lagje të rrugëve; sistemim mbeturina në fushat ekzistuese), por me ndryshimin e elementeve sasiorë si në volume ashtu dhe në vlerë financiare.

Në bazë të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, pika 10; bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.” si dhe ligjit 8094/1996 “Për largimin publik të mbeturinave” i ndryshuar; bashkia nëpërmjet strukturave përgjegjëse organizon mbledhjen dhe largimin e mbeturinave nga persona fizikë e juridikë, publikë e privatë të përzgjedhur nëpërmjet procedurës së prokurimit publik, që janë të specializuara në shërbimet e pastrimit dhe grumbullimin e mbeturinave si dhe ka për detyrë të:

- Caktimin e koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara për dorëzimin e mbeturinave.
- Përcaktimin e metodave dhe teknologjive që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave;
- Miratimin e rregullores për shërbimin e pastrimit publik dhe ndarjen territoriale në zona pastrimi të bashkisë;
- Lidhjen e kontratave të pastrimit me sipërmarrësit për çdo zonë pastrimi;
- Caktimin dhe mbledhjen e taksës për pastrimin.

Për realizimin e shërbimit të pastrimit në qytetin e Vlorës dhe njësinë Orikum në nivel sa më cilësor në rastet kur paraqiten 3 ose më shumë vërejtje të njëpasnjëshme për mos realizimin e shërbimit objekt të kësaj analize apo elemente të veçanta të tij, përben shkak për prishjen e menjëhershme në mënyrë të njëanshme të kontratës.

Në llogaritjen e kostos së këtij shërbimi, në kuptimin e këtij ligji “**Mbeturina**”, janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaritë njerëzore, ekonomi shtëpiake të braktitura a që janë të destinuara për braktisje. Në kuptim të këtij ligji me emërtimin “mbeturina” përfshihen:

- a) Papastërtitë që dalin nga shtëpitë e banimit, mbeturinat e kuzhinës, rrecka, cifla, kanoçe, hi, blozë, plastike etj.
- b) Papastërtitë që dalin nga lokalet.
- c) Papastërtitë që dalin nga kopshtet, lulishtet dhe oborret funksionale të ndërtesave publike (lokale, restorante) etj.
- ç) Papastërtitë që dalin nga ndërmarrjet private e shtetërore, të shkaktuara nga prodhimi, si ai artizanal, tregtar, i shërbimeve etj.
- d) Papastërtitë që dalin nga ndërtimet e ndryshme, si rëra, dhera etj., që janë në masë të parëndësishme sa 1/10 m³.

Nuk përfshihen në llogaritjen e kostos dhe nuk përfshihen në largimin publik të mbeturinave:

1. Mbetjet radioaktive.
2. Mbetjet nga puna kërkimore, industria nxjerrëse e përpunuese e trajtimit dhe e grumbullimit

të pasurive minerare të shfrytëzimit të vendburimeve të ndryshme.

3. Toka, balta, bora, akulli, fekalet, mbeturinat që vijnë nga lëndë të shuara ose të nxehta.

4. Mbeturina zanati, papastërtitë e stallave, kadavrat, lëngjet, mbetjet e vajrave lubrifikante e të benzinës.

5. Lëngjet eksplozive, substancat gërryese, mbetjet e ngjyrave e të karbiteve.

6. Ngordhësit.

7. Mbetjet bujqësore.

8. Lëndët shpërthyese dhe eksplozive.

9. Materialet fekale.

10. Mbetjet nga ndërtimet dhe meremetimet e objekteve e të veprave me përmasa mbi 1/10 m³.

11. Lëndët materiale të tjera që ndodhen jashtë vijës kufizuese të qyteteve a komunave, si dhe lëndë e materiale të tjera që parashikohen e disiplinohen me ligje të veçanta.

12. Mbeturinat e tjera të çdo lloji që gjatë largimit të tyre shkaktojnë dëmtime dhe mund të vënë në rrezik organizma që merren me largimin e tyre, nxjerrin në ajër lëndë të ndryshme, sjellin shkatërime etj.

13. Klasifikimi dhe përcaktimi konkret i mbeturinave dhe i natyrës së tyre do të bëhet në rregulloren e shërbimit të pastrimit.

Shërbimet e analizuara në kuadër të këtij studimi janë: heqje mbeturinash urbane dhe inerte, fshirje dhe larje rrugësh, dhe numrin e koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara për dorëzimin e mbeturinave. Secili prej tyre ka veçantitë dhe karakteristikat e veta në ndikimin realizimit të këtij shërbimi. Në rrugët e kategorisë së parë e të dytë do të vendosen kontejnerë me kapacitet 1,1 m³, ndërsa për zonat e rrugës së kategorisë të tretë e të katërt në zonat periferike të qytetit do të vendosen kontejnerë me kapacitet 1,7 m³.

Analiza e kostos është krijuar mbi bazën e një eksperience të gjatë të Bashkisë Vlorë, duke marrë për bazë shumë elemente të domosdoshëm për këtë analizë të kostos. Në funksion të këtij studimi janë hartuar skicat e rrugëve dhe shesheve të qytetit të Vlorës dhe Orikumit që janë objekt i këtij shërbimi, si dhe skica e vendit të grumbullimit të mbetjeve. Këtu nuk janë përfshirë njesitë administrative Qender, Shushice dhe Novosele, pasi ofrimi i këtij shërbimi ndodhet në proces gjyqësor, midis Bashkisë Vlorë dhe operatorëve pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të vitit 2016. Deri në përfundimin e procesit gjyqësor, shërbimi i pastrimit do të kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publikë në Bashkinë Vlorë.

Tabela e mëposhtme jep koeficientet e llogaritjes së ditëve të punës në vit për efekt të llogaritjes së pagës në bazë të Kodit të Punës (ore nate, dite pushime, dite festa).

A						
nr	muaji	Njesia	dite pune	pushim	festa	totali
1	janar	dite	21	8	2	31
2	shkurt	dite	20	8		28
3	mars	dite	20	9	2	31
4	prill	dite	20	8	2	30
5	maj	dite	20	10	1	31
6	qershor	dite	21	8	1	30
7	korrik	dite	23	8		31
8	gusht	dite	20	10	1	31
9	shtator	dite	21	8	1	30
10	tetor	dite	22	9	0	31
11	netor	dite	19	9	2	30
12	dihjetor	dite	21	8	2	31
	totali	dite	248	103	14	365
B 1	Konvertohet: turni I nates per 365 - 50 % (ngarkim, transport)	dite	248	103	14	182.5
B 2	Konvertohen: festat dhe pushimet me 50 % (sistemim mbeturina)			103	14	58.5
B 3	Konvertohen: turni I nates per 26 dite ne muaj (314 dite ne vit, fshirja)		248	51.5	14	157.0
B 4	Konvertohen: turni I nates me 50 % (larje turn nate dite pune)		228			114.0
C	Totali I diteve					
C 1	Totali I diteve B1		248	103	14	547.5
C 2	Totali I diteve B2			103	14	423.5
C 3	Totali I diteve B3		248	51.5	14	405.0
C 4	Totali I diteve B4		228			342.0
D	Dite pune per 1 punonjes ne vit 11 muaj(248-20)	dite	228			228.0
E	Numri I punonjese (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C1/D)	punonjes				2.40
	Numri I punonjese (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C2/D)	punonjes				1.86
	Numri I punonjese (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C3/D)	punonjes				2.07
	Numri I punonjese (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C4/D)	punonjes				1.50

Nga studimi i përbashkët i zhvilluar nga Bashkia Vlore dhe Konsulenti Institucional kemi analizën e tregueseve të mëposhtëm:

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Netor	Dhjetor
Numri i ditëve	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31
Shpërndarja e trafikut turistik						15%	35%	35%	15%			
Shpërndarja e sasisë së mbeturinave						389.9	909.7	909.7	389.9			
Mbetje shtesë në ditë						13.00	29.34	29.34	13.00			
Numri i qëndrimeve gjatë natës						241,921	564,482	564,482	241,921			
Shpërndarja e popullsisë	70%	75%	80%	85%	100%	130%	155%	155%	130%	90%	80%	70%
Popullsia në muajin aktual	109,110	116,904	124,698	132,491	155,872	202,634	241,602	241,602	202,634	140,285	124,698	109,110
Sasia e mbetjeve ditore	98	105	112	119	140	182	217	217	182	126	112	98
Sasia e mbeturinave ditore duke përfshirë mbetjet e turistëve	98	105	112	119	140	195	247	247	195	126	112	98

Nga tabela e mësipërme mesatarja ditore totale është 150 ton mbetje / dite, nga të cilat 140 tone në qytetin e Vlorës dhe 10 tone në Njësinë Orikum

Aktualisht qyteti i Vlorës dhe Orikut ka afërsisht 155,872 banorë (Qyteti Vlore 143 932 dhe Njesia Orikum 11 940 banorë), dhe 4900 subjekte biznesi. Këto statistika janë bazuar në të dhënat e Gjendjes Civile. Si qytet bregdetar me sektorin e turizmit në zhvillim janë marrë parasysh në këtë studim dhe numri i turistëve, ku sipas të dhënave nga burime të ndryshme, numri i ditëve të qëndrimit llogaritet në

rreth 1.6 milione dite qëndrimi (turiste te huaj dhe vendas).

Sipas te dhënave zyrtare te INSTAT (Publikimi i fundit, 19 Shtator 2018) prodhohen mesatarisht rreth 1.06kg/banor ne dite, ku përfshihen edhe mbetjet inerte sipas ligjit. Sasia e mbetjeve ditore urbane sipas standarteve arrin 1.06 kg/fryme, kurse mbetjet e tjera dhe inerte zënë rreth 30% e sasisë ditore, e marre kjo nga sasia ditore te hedhura jashtë kontejnerëve. Ne këtë sasi te mbetjeve janë llogaritur dhe mbetje te tilla si elektroshtepiake, mobilje te vjetra, mbetjet e kopshteve të shtëpive private. Gjithashtu burim tjetër per llogaritjen e sasisë se mbetjeve urbane për frymë janë dhe kontratat e mëpareshme qe ka lidhur Bashkia Vlore (0.9 kg/fryme ne dite). Duke u nisur nga këto dy burime, analiza e mëposhtme do te mbështetet ne eksperiencën e bashkisë Vlore ne kontratat e mepareshme (0.9 kg/fryme ne dite)

Për ofrimin e shërbimit duhen minimalisht 795 (për efekt të analizës 800) kontejner per muajt Janar, Shkurt, Mars, Dhjetor; duke arritur maksimumin ne muajin Korrik, Gusht me 1,716 kontejnerë. Aktualisht në qytetin e Vlorës janë 600 pika, në të cilat janë shpërndarë 795 kontenierë ku heqja e mbetjeve bëhet me mjete teknologjike, si dhe me mjete transporti, për mbetjet e hedhura jashtë kontenierëve. Gjatë zbatimit të kontratës për shkak të rikonstruksionit të blloqeve të reja të banimit, apo rehabilitimit të rrugëve, synohet që në qytet të jenë 1100 kontenierë dhe një numër më i madh pikash.

Kontenierët janë vendosur kryesisht në blloqet e banimit, rrugë kryesore, apo në pika të vecanta, kurse në zonat periferike ekzistojnë edhe pika grumbullimi të mbetjeve që nuk ka kontenierë por që heqja kryhet me mjete transporti (në analizën e kosos janë parashikuar mjetet teknologjike, mjetet e transportit, fadroma për heqjen e mbetjeve).

Sipas analizës për arsye te hapësirave dhe te mos spostimit te kontejnerëve do te vendosen ne total 800 kontejnerë ne 600 pika në qytetin e Vlorës si dhe 215 në njësinë Orikum. Për periudhën e sezonit do te kete mbledhje te mbeturinave 1 here ne dite ne kushte normale dhe 2 herë në ditë për gjatë sezonit turistik (per tu detajuar sipas rrugëve dhe ngarkesës). Gjatë sezonit turistik do të ketë edhe brigada punëtorësh të përbërë nga 15-20 persona të dedikuara për zona të vecanta, sikurse është zona e Lungomares, Unaza e Qytetit, Rruga Dhimitër Konomi, Shëtitorja në Orikum, etj (Detajime do të bëhen edhe në kontratë).




Ne kontratën përfshihet edhe fshirja e rrugëve, trotuareve dhe shesheve. Rrugët dhe sheshet e

kategorisë se pare e te dyte do fshihen me autofshese, kurse trotuaret e rrugeve te kategorise se pare, rrugët e kategorisë se trete e te katërt do te fshihen me punëtoze.

Rrugët kryesore te qytetit do mirëmbahen duke kryer pastrimin çdo dite.

Nr.	Rrugë	Gjatesia m (L)	Asfaltim Rrugë (m2)					Trotuar (m2)	Fshihen me Autofshes Sip. m2	Fshihen me Puntor Sip. m2	Rr. Qe Lahen Sip. m2
			ORIKUM	RADHIME	TRAGJAS	DUKAT I RI	DUKAT FSHAT				
1	PRINCESHA RUGJINE	790	9,465					3,720	9,465	3,720	9,465
2	DEMOKRACIA	910	8,200					4,515	8,200	4,515	8,200
3	POMPEI	927	4,175					1,550	4,175	1,550	4,175
4	ORIKU	1,350	13,500					7,772	13,500	7,772	
5	MARMIROI	600	4,800					2,500	4,800	2,500	4,800
6	JUL CEZARI	352	1,580					702	1,580	702	1,580
7	MUSA SHEHU	220	1,100					440	1,100	440	
8	GJERGJ FISHTA	446	2,010					700	2,010	700	
9	KAONET	355	2,487					217	2,487	217	2,487
10	AHMET ZOGU		382						382		
11	EQEREM BEJ VLORA		457						457		
12	YZEIR ALIMERKO (BLLOKU)		1,582					780	1,582	780	
13	FAIK KONICA (AMBULANCA)		472						472	472	
14	SHETITORE PASHALIMAN (BREGDETI)	958	6,710						6,710		
15	SHETITORE PASHALIMAN (XHENJO)	489	2,446						2,446		
16	SHESHI PARA SHKOLLES							715		715	
17	BLLOKU TE KISHA							2,173		2,173	
18	BLLOKU TE URA							2,240		2,240	
19	JERONIM DE RADA	536		4,560				1,285	4,560	1,285	
20	ALEM MEHMETI	630			3,155				3,155		
21	HAMIT SELMANI	1,170				7,650		4,400	7,650	4,400	
22	MALIQ KOSHENA					1,215			1,215		
23	DERVISH ALI AJANI						3,020		3,020		
24	SHKOLLA E KUQE'							1,200		1,200	
Totale			59,366	4,560	3,155	8,865	3,020	34,909	78,966	35,381	30,707

Pika e depozitimit te mbetjeve dhe vend-depozitimi i Orikumit (sipas skices).



Ne baze te te dhenave dhe studimeve te deritanishme eshte kryer analiza e kostos me qellim nxjerrjen e fondit qe do te vihet ne dispozicion te shërbimit.

BAZA LIGJORE

Baza ligjore mbi te cilën është mbështetur kjo analizë kosto është si më poshtë:

1. Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore".
2. Ligji nr.8094 datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave".
3. Kodi i Punes i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr.7961 dt.12.07.1995, i ndryshuar.
4. Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.
5. VKM nr.809 dt.26.12.2018 "Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi".
6. VKM Nr.319, datë 21.6.1994 "Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave".
7. VKM nr. 510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" (kreu III pika 2)
8. Urdhër nr.180 dt.21.08.2019 "Për ngritjen e grupit të punës për matjen e sipërfaqeve të rrugëve, shesheve dhe blloqeve të banimit me infrastrukturë të rregullt në qytetin e Vlores".
9. VKM 717/2009 - Për Pagat E Punonjësve Mbështetës Të Institucioneve Buxhetore Dhe Të Nëpunësve Të Disa Institucioneve Buxhetore I Përditësuar (Shkalla 1).
10. VKM nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"

ANALIZA E KOSTOS SE SHERBIMIT PER PASTRIMIN URBAN NJESIA ORIKUM

2. ANALIZE KOSTO NJESIA ORIKUM

SHERBIMI 1 : “Ngarkim, transport mbeturina“ (10 Ton/dite, 215 kontejnerë)

Qëllimi i punes: Heqja periodike e mbeturinave nga pikat e grumbullimit me konteniere metalike dhe kosha betoni në gjithë njësinë Orikum, si dhe transportimi i tyre ne fushën e grumbullimit. Ky shërbim do te kryhet sipas grafikut te shërbimeve ne marrëveshje me sipërmarrësit, duke patur parasysh terrenin e vështire te disa fshatrave.

Pershkrimi i punes:

- Mjetet e transportit te mbeturinave sipas destinacionit te caktuar kryejne transportin e mbeturinave nga qyteti ne fushën e grumbullimit.
- Punëtorët e transportit kane per detyre te heqin te gjithë mbeturinat familjare nga pikat e grumbullimit, te bejne fshirjen me fshese dhe dezinfektimin me gelqere te vend grumbullimit me nje rreze prej 3 ml.
- Transporti i mbeturinave nga qyteti Orikum dhe fshatrat e njesisë deri ne fushën e grumbullimit.





Per përpunimin e 10 ton mbeturina janë vendosur në total 215 konteniere. (Subjektet pjesëmarese në planbiznesin e paraqitur, mund planifikojnë të rrisin numrin e kontejnerëve brenda pikave të miratuara nga Bashkia).

Per heqjen e sasisë së mbetjeve prej 10 ton në ditë (3650 ton në vit), duke u nisur nga eksperiencat e mëparshme në lidhje me shtrirjen e shërbimit, nevojiten automjete teknologjike të kapacitetit deri në 10 m³ për arsye se në zonat e caktuara është e pamundur hyrja e automjeteve me kapacitet më të madh se 8-10 m³, si dhe krijohet trafik i rënduar në zonën turistike.

Është vënë re se makinat teknologjike nuk shkon çdo ditë në çdo fshat për mbledhjen e mbeturinave në kontejner për shkak të sasisë së ulët të gjeneruar të mbetjeve në këtë zonë. Mjeti teknologjik lëviz gjithë muajin në bazë të një grafiku të miratuar me kontraktorin gjatë muajit. Për efekt analize makineria do të llogaritet shpenzimet për 365 ditë. Gjithashtu duke pasur parasysh terrenin dhe shpërndarjen gjeografike të pikave (fshatrave) është e domosdoshme nga eksperiencat të planifikohen dhe 1 kamionçinë për mbledhjen e mbetjeve (zonat rurale).

1	Page shofere 2 shof/teknol + 3 punëtorë	
2	Kontribute	
3	Dizinfektant (gelqere) 78475 kont/vit.x 0.1 kg/kont	
4	Vegla pune. lopata fshesa etj, 6 puntore (3 x 1.86) = 6 punëtor	
5	Pjesë kembimi konteniere 215 x 0.1 rrota/muaj	
6	Karburant. I-1 auto x 365dp/vit:12muaj = 365dp/muaj II 1 auto x 30 dp/muaj Shuma I + II =	
7	Goma auto. 1 auto x 6 goma/vit 1 auto x 4 gom/vit	
8	Pjesë kemb. auto. 365	
9	vaj hidraulik. 1 auto teknologjik Nderim vaji çdo 1000 ore pune, çdo 4 muaj =3her/vit x 1 =3 here	

	3 here	
10	Vaj motori. 2 auto x 6 lit/muaj x 419 lek/lit	
11	Rroba pune. 5 pale/vit x 4920 leke : 12muaj	
12	Antidode. 5 puntore x 1335 leke/muaj	
	Totali mesatar mujor	

TOTALI LEK/muaj

Strukture & fitim 18%

Shuma lek/muaj

Shuma leke/vit

Kosto per ton

leke/vit / 3650 t/vit = 2548.9 leke/ton

Pjese e këtij shërbimi është edhe larja dhe pastrimi i kontejnerëve. Ky detajim do të percaktohet në kontratë.

SHERBIMI 2: “Fshirje e rrugëve dhe shesheve” (114 347 m2 / dite).

Per njësinë Orikum dhe në veçanti qyteti i Orikut dhe pjesa bregdetare sipërfaqja totale që është trajtuar me fshirje aktualisht është 114 347 mije m2/dite, nga të cilat 82734 m2 në qytetin e Orikut dhe shëtitoret perkatese. Ky shërbim për qytetin e Orikut do të kryhet nga ora 22.00 - 06.00 për 26 dite pune në muaj. Për pjesën tjetër të njësisë (31 613 m2), shërbimi i fshirjes do të kryhet nga ora 08.00 - 16.00, 3 here në javë. Në tabelën e mëposhtme jepen të detajuara sipërfaqet për çdo njësi.

Rrugë	Gjatesia m (L)	Asfaltim Rrugë (m2)					Trotuar (m2)	Fshihen me Autofshes Sip. m2	Fshihen me Puntor Sip. m2	Rr. Qe Lahen Sip. m2
		ORIKUM	RADHIME	TRAGJAS	DUKAT I RI	DUKAT FSHAT				
PRINCESHA RUGJINE	790	9,465					3,720	9,465	3,720	9,465
DEMOKRACIA	910	8,200					4,515	8,200	4,515	8,200
POMPEI	927	4,175					1,550	4,175	1,550	4,175
ORIKU	1,350	13,500					7,772	13,500	7,772	
MARMIROI	600	4,800					2,500	4,800	2,500	4,800
JUL CEZARI	352	1,580					702	1,580	702	1,580
MUSA SHEHU	220	1,100					440	1,100	440	
GJERGJ FISHTA	446	2,010					700	2,010	700	
KAONET	355	2,487					217	2,487	217	2,487
AHMET ZOGU		382						382		
EQEREM BEJ VLORA		457						457		
YZEIR ALIMERKO (BLLOKU)		1,582					780	1,582	780	
FAIK KONICA (AMBULANCA)		472						472	472	
SHTETITORE PASHALIMAN (BREGDETI)	958	6,710						6,710		
SHTETITORE PASHALIMAN (XHENJO)	489	2,446						2,446		
SHESHI PARA SHKOLLES							715		715	
BLLOKU TE KISHA							2,173		2,173	
BLLOKU TE URA							2,240		2,240	
JERONIM DE RADA	536		4,560				1,285	4,560	1,285	
ALEM MEHMETI	630			3,155				3,155		
HAMIT SELMANI	1,170				7,650		4,400	7,650	4,400	
MALIQ KOSHENA					1,215			1,215		
DERVISH ALI AJANI						3,020		3,020		
SHKOLLA E KUQE'							1,200		1,200	
Totale		59,366	4,560	3,155	8,865	3,020	34,909	78,966	35,381	30,707

Kjo sipërfaqe është llogaritur në total, por gjatë zbatimit të kontratës mund të ketë ndryshime të shesheve, rrugëve, trotuare pa ndryshuar sipërfaqen totale.

a. Fshirje me mjet teknologjik

Qëllimi i punës : Rrugët dhe sheshet e kategorisë së parë e të dytë që llogariten me një sipërfaqe prej rreth 78 966 m² nga të cilët 59366 do të fshihen çdo ditë dhe 19600m² - 3 here në javë do të kryhet fshirja me mjet teknologjik (autofshese), pasi kërkojnë një shërbim me cilësor. Ky shërbim do të kryhet për të eliminuar pluhurin dhe për të përmirësuar me shumë cilësinë e pastrimit të rrugëve.

Bazuar në kontratat e mëparshme një autofshese mund të realizojë fshirjen e një sipërfaqe prej 8000m²/orë ose rreth 64 000 m² për 8 orë. Ky shërbim do të kryhet me 1 autofshese që do të fshijë 64 000 m².

Nr.	Shpenzimi	Vlera
1	Karburant 1 autofsh x (26 dp/muaj +3.7 ditë pune)	
2	Fshesa. 1 autofsh x 1,5 komplet/muaj	
3	Punetore (1 shofer) x 2 x 26 000 leke + 3.7 ditë pune	
4	Kontribut	
5	Pjesë kembimi. 1 x 29.7dp/muaj	
6	Vajra lubrifikant &hidraulik. 1 auto	
7	Antidode. 1 pun	

a. Fshirje me fshese

Qëllimi i punës: Trotualet e rrugëve të kategorisë së parë, rrugët e kategorisë së tretë e të katërt do të fshihen me punëtore. me një sipërfaqe prej rreth 35381 m² nga të cilët 23368 do të fshihen çdo ditë dhe 12013m² - 3 here në javë do të kryhet fshirja (rreth 6000 metra katror në ditë). Në llogaritjen e kësaj analize norma ditore për fshirjen me fshese është rreth 5600 m² për punëtore (si dhe zhvendosja në zonë). Për fshirjen e një sipërfaqe prej 23368 m² në ditë nevojiten rreth 4.2 punetore për Orikumin dhe 1 punonjes për fshatrat .

Përshkrimi i punës :

- Pastrim me fshese i sipërfaqes së caktuar, kruajtje e mbetjeve të vogla prej balte dhe mbeturinave të tjera mbi sipërfaqet e rrugëve dhe shesheve.
- Grumbullim i mbeturinave dhe transportimi i tyre me karroce dore për në vend të grumbullimit me të afert.
- Grumbullimi i mbeturinave të fshira me fshese melakuqe e lopate, zbrazja e koshave rrugore.

Nr.	Emertimi	Vlera
1	Page për punonjes. (4.2 x 2.06 + 1)	
2	Kontribut.	
3	Shpenzime materiale. (karro, lopata, fshesa etj,..) 5 pun	
4	Rroba Pune. 5	
5	Antidode. 5 pun	
	Totali	

Per te kryer kete sherbim nevojiten keto shpenzime:

Shuma a+b LEK/muaj = leke

Strukture & Fitim 18% = leke

Totali leke = leke

lek/muaj x 12 muaj **TOTALI LEK/vit = leke/vit**

Fshirje me mjet teknologjik =

Kosto per m2 -

Fshirje me fshese =

Kosto per m2

SHERBIM 3 : “LARJE E SHESHEVE DHE RRUGEVE ME UJE”

Sherbimi i larjes me uje i rrugeve kryesore qe kane kunet te rregullt per shkarkimin e ujrave te lahen me presion naten (01.00 - 06.00) per nje periudhe 10 mujore/vit per 26 dite ne muaj. Kjo do te beje te mundur eliminimin e baltës dhe pluhurave ne rruge. Sipërfaqja qe do te trajtohet me kete sherbim eshte 30,707 m²/dite (sipas hartave bashkëlidhur analizës)

Realizimi i ketij sherbimi do te kryhet me mjete (bote) me kapacitet mesatar 16 m³ - 18 m³ uje. Ky sherbim do te kryhet per nje periudhe 10 mujore sipas grafikut te percaktuar ne kontrate, nga ora 01.00 - 06.00. Bazuar ne kontratën ekzistuese, ne llogaritjen e kesaj analize norma ditore per larie me nje autobot me kapacitet mesatar 17 m³ uje eshte 0.5. lit/m². Atëherë 30 707 m² rruge X 0.5 lit/m² = 15 m³ uje ne dite.

Sherbimi i lagies me uje do te kryhet me te njejtin mjet ne vazhdimesi te sherbimit te larjes se rrugeve, per nje periudhe 10 mujore gjate dites (ne oren 15.00-18.00). Bazuar ne kontratat e mepareshme ne llogaritjen e kesaj analize norma ditore per lagie me nje autobot me kapacitet mesatar 17 m³ uje eshte 0.25 lit/m². Atehere 30,707 m² rruge X 0.25 lit/m² = 8 m³ uje ne dite.

Bazuar ne kapacitetin e mesiperm nje autobot e kryen mesatarisht 1 rruge ne 2 ore brenda kohes se percaktuar (nje autobot me kapacitet mesatar 16-18 m³ i nevojitet mesatarisht 2 ore per nje rruge). Ne total per realizimin e ketij sherbimi duhet 1 autobot

Ne total per realizimin e ketij sherbimi duhen mesatarisht 1 autobote.

1	Page 1 shofer x 2.4 (turni i natës)	
2	Kontribute	
3	Karburant. 1 auto x 30 dite	
4	Goma auto. 1 auto x 4 gom/vit	
5	Pjes kemb.auto. 1 mjete * 300 dp/muaj	
6	Vaj motori. 1 auto x 20 litra * 2 here ne vit	
7	Rroba pune. 1 pale/vit	
8	Antidode. 1 punëtorë	
	Totali mesatar mujor	

TOTALI LEK/muaj leke
 Strukture & fitim 18% leke
Shuma lek/muaj leke
Shuma leke/vit leke
Sipërfaqe totale vjetore m2

Kosto per njësi leke/m2

SHERBIMI 4: “Sistemim mbeturina ne fushen e depozitimit” (10/dite)

Per sistemimin e nje volumi 10 T ne dite mbeturinash ne fushen e depozitimit te mbeturinave nevojitet nje buldozer me kohe te reduktuar prej 2 oresh ne dite, per te cilin nevojiten keto shpenzime:

Nr.	Emertimi	Vlera
1	(Pag manovrator & puntor 2 x 1.86 x 26 000 lek/muaj) : 8 ore pune x 2 ore	24,180
2	Kontribut. 24,180 leke x 16.7%	4 038
3	Karburant (365 dit x 63 lit/dit konsum x 132.14 lek/litër : 12 muaj =319 247) : 30 dite ne muaj : 8 ore ne dite x 2 ore dita	2 110
4	Pjes Kembimi (365 dit x 1650 lek/dit : 12 muaj = 50 187) : 30 dite ne muaj : 8 ore ne dite x 2 ore dita	418
5	Lubrifikante (Vajra,graso etj) 365 dit/vit x 500 lek/dp: 12 muaj = 15 208) : 30 dite ne muaj : 8 ore ne dite x 2 ore dita	126
6	Veshmbathje. 2 x 4 920 lek punëtor/vit : 12 muaj	820
7	Antidode. 2 x 1335 leke/muaj : 30 dite ne muaj : 8 ore ne dite	22
	Totali	31 714

LEKE/MUAJ = **31 714 leke.**
Strukture& Fitim 18% = **5,708 leke**
Totali leke/muaj = **37 423 leke**

38,071 leke/muaj x 12 muaj = 449 070 leke/vit

Kosto1/kont sistemim ne fushën e depozitimit te mbeturinave = **449 070 leke/vit : 3650 T /vit**
 = 123 leke/T.

TABELE PERMBLEDHESE NJESIA ORIKUM

Duke nxjerre shpenzimet për çdo ze pune me poshtë po paraqesim preventivin e plote vjetor i cili përbehet nga këto shpenzime:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Sherbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
	Ngarkim, transport mbeturina	3650 t/vit	leke/ton		12 muaj
		78 475 kontenier/vit	lek/kon		
	Fshirje e rrugëve dhe shesheve	35,904,958 m2/vit	leke/m2	10,885,217	12 muaj
	<u>Fshirje me mjet teknologjik</u>	21 344 592	leke/m2	6 543 959	12 muaj
	<u>Fshirje me fshese</u>	9 020 688	leke/m2	4341258	12 muaj
	Larje rrugëve me uje	8 763 820	leke/m2	1 478 680	10 muaj
	Sistemim mbeturina	3650 t /vit	l/t	449,070	12 muaj
Çmimi Neto per 1 vit					
TVSH (%) per 1 vit					
Çmimi Total per 1 vit					
Çmimi Neto per 3 vjet					
TVSH (%) per 3 vjet					
Cmimi total 3vjet					